



Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1208_09_14**;
- Ankesa e konsumatorit e datës 23.09.2014

në seancën e mbajtur më datë 03 tetor 2014, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZOHET** ankesa e konsumatorit A. J. me shifër DPR 90093343 nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1208_09_14 i datës 09.09.2014.

Arsyetim

Konsumatori A. J. me datë 31.12.2013 sipas rregullave dhe procedurave në fuqi ka parashtruar kërkesën në KEDS për lidhje të re.

Me datë 25.01.2014 punëtorët e autorizuar të KEDS-it për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë bërë pranimin teknik të njehsorit elektrik nr. 39072268 me gjendje të shpenzimeve të regjistruara: TL=210 kWh dhe TU=200 kWh, dhe kanë evidentuar se fuqia angazhuese është 14 kW, si dhe kanë evidentuar se njehsori teknikisht është në rregull. Pas kësaj me datë 27.01.2014 Departamenti i Faturimit në KEDS e ka faturuar konsumatorin me shërbime për lidhje të re në vlerë prej 371.20€.

Me datë 05.02.2014 konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin e përkujdesjes së konsumatorëve në KEK duke kundërshtuar faturimin për shërbimet lidhje e re. Me datë 07.03.2014 Departamenti për Konsumator në KEDS iu është përgjigjur konsumatorit duke e refuzuar ankesën e tij bazuar në procesverbalin nr. 030686 të datës 25.01.2014 ku fuqia angazhuese është 14 kW. Konsumatori pas marrjes së përgjigjes së KEDS-it ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE. DMK pas parashtrimit të ankesës së konsumatorit ka bërë shqyrtimin e ankesës dhe me datë 09.09.2014 ka nxjerr vendim duke e refuzuar ankesën e konsumatorit.

Konsumatori me datë 23.09.2014 brenda afatit të paraparë ligjor ka kundërshtuar vendimin e DMK në Bordin e ZRRE-së



Baza e kundërshtimit të konsumatorit se vendimi i DMK në ZRRE është vendim i padrejtë. Konsumatori në ankesë ka theksuar se ai është ankuar në zyrën për mbrojtjen e konsumatorëve për gabimin që i është bërë gjatë pranimit teknik për kyçje të lokalit dhe për këtë ka marrë përgjigje negative. Konsumatori ka theksuar se komisioni ka gabuar gjatë vlerësimit të shpenzuesve duke e vlerësuar një vinq i cili është 2.2 kW, e ata e kanë vlerësuar si 10 kW dhe gabimi tjetër është bërë me një kompresor i cili ka qenë jashtë funksionit dhe ai ka ardhur për tu rregulluar meqë lokali ka shërbyer si auto elektro dhe se kompresori nuk hyn në këtë punë. Konsumatori si dokumente shitesë të kësaj ankesë i ka bashkangjitur edhe disa fotografi nga lokali, si fotoja e vinqit dhe tiketën e karakteristikave teknike të vinqit, si dhe fatura e muajit 06/2014 prej 248 kWh. Në fund të ankesës konsumatori thekson se kërkon nga Bordi i ZRRE-së që të shqyrton ankesën e tij dhe të merr një vendim të duhur bazuar në faktet e prezantuara.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 03 tetor 2014 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit, dhe pas vlerësimit të gjitha këtyre shkresave ka vërejtur se DMK, ka vepruar konform dispozitave ligjore në fuqi me rastin e marrjes së këtij vendimi. Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se pas parashtrimit të kërkesës së konsumatorit për lidhje të re, punëtorët e autorizuar të pranimit të njehsorit elektrik kanë dalur te konsumatori dhe në procesverbalin e pranimit teknik të instalimit elektrik nr. 030686 të datës 25.01.2014 kanë bërë pranimin e njehsorit elektrik nr. 39072268 dhe kanë evidentuar edhe fuqinë angazhuese prej 14 kW. Bordi i ZRRE-së ka vërejtur poashtu se me rastin e pranimit të instalimit të njehsorit elektrik nr. 39072268 konsumatori ka qenë veç se i kyçur në rrjetin elektrik dhe këtë e vërteton edhe evidentimi i shpenzimit të energjisë elektrike në tarifën e lartë dhe tarifën e ulët.

Sa i përket pikës së ankesës së komisioni ka bërë vlerësimin e gabuar të shpenzuesve, Bordi i ZRRE-së thekson se Rregullës për kushtet e përgjithshme të furnizimit me energji, konsumatorët të cilët aplikojnë për lidhje të re faturohen me taksën për shërbime për lidhje të re bazuar në dokumentin "Procedura lidhëse" apo çmimoren e aprovuara nga ZRRE e në të cilën janë të përshkruara dhe paraqitura të gjitha taksat që duhen të zbatohen nga operatorët me rastin e aplikimit të konsumatorit. Pra, sipas këtij dokumenti është llogaritur vlera totale prej 371.20€, llogaritet duke marrë për bazë që taksa për lidhjen në rrjetin elektrik trefazor është 40 €, ndërsa për 1 kW te konsumatorët komercial të kyçur në rrjetin 0.4 kV është vlera prej 20€, që sipas kësaj pasi që në procesverbalin e pranimit teknik është evidentuar vlera prej 14 kW (1kW x 20€) atëherë është 280.00€. Pra sipas kësaj vlera prej 280.00€ paraqet vlerën financiare të llogaritur për fuqinë prej 14 kW, taksa për shërbime për lidhje të reja në rrjetin trefazor është 40€, si dhe kur llogaritet edhe TVSH, atëherë vlera totale është 371.20€.

Bordi i ZRRE-së gjatë analizës së bërë fotografive të prezantuara nga konsumatori dhe faturës së energjisë elektrike të periudhës 06/2013 konsideron se këto fotografi tregojnë vetëm gjendjen e lokalit të konsumatorit dhe fuqinë e vinqit, por që nuk janë dëshmi të mjaftueshme për të vërtetuar kundërshtimet se fuqia angazhuese prej 14 kW e evidentuar në procesverbalin e regjistrimit të njehsorit elektrik nga punëtorët e autorizuar të KEDS-it nuk është i saktë, si dhe duke pasur parasysh se punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë evidentuar poashtu edhe profilin e kabllit furnizues i cili është 4 x 16 mm².

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 03.10.2014 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1193_08_14, dhe pas analizimit të hollësishëm të



të gjitha dëshmive tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar